

Vendim nr. 149 datë 06.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 06.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (R) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: REFIE PATOZI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 407, datë 13.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 00-2022-1715(343), datë 20.12.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, pika 1, 42, pikat 1 dhe 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka qenë e punësuar në shoqërinë tregtare “Porti Detar Vlorë” sh.a., në detyrën e Përgjegjëses së Sektorit të Administrimit Financiar nga data 01.04.2013-05.03.2014, ndërkohë që ka qenë punonjëse në këtë shoqëri prej vitit 2007. Ajo është proceduar penalisht nga Prokuroria pranë

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kallëzimit penal të shoqërisë punëdhënëse të saj. Në përfundim të hetimit paraprak kërkuesja është dërguar për gjykim përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për akuzën e kryerjes së veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve” më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 2, i Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pas shqyrtimit të çështjes me procedurën e gjykimit të shkurtuar, me vendimin nr. 407, datë 13.07.2015, e ka deklaruar kërkuesen fajtores për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 2, i KP-së, duke e dënuar me 1 vit burgim, i cili është ulur me 1/3 në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ndërkohë që, në aplikim të nenit 59 të KP-së, është pezulluar ekzekutimi i këtij dënimi, duke u vënë kërkuesja në provë për një kohë prej 18 muajsh. Gjykata ka pranuar se kërkuesja, në përmbushje të detyrës së saj funksionale të kontrollit mujor për gjendjen e arkës së shoqërisë në lekë dhe valutë, ka përpiluar procesverbalin e datës 31.10.2013 “Mbi kontrollin e gjendjes fizike të arkës”, i cili krahas nënshkrimit të kërkueses mban edhe atë të llogaritares arkëtare R.Sh. Është pranuar po ashtu, se në përmbushje të detyrës së përpilimit të listëpagesave të punonjësve në bazë të kohëshënuesve apo listë prezencës së tyre, në listëpagesat për muajt tetor dhe nëntor 2013, kërkuesja ka përfshirë edhe llogaritaren arkëtare R.Sh. Kjo e fundit ka mohuar të ketë nënshkruar në procesverbalin e datës 31.10.2013. Ajo për periudhën 15.10.2013 - 14.11.2013 nuk është paraqitur në punë, ndërsa ka qenë e larguar jashtë vendit për arsye shëndetësore. Referuar këtyre fakteve, gjykata ka arritur në përfundimin se në veprimet e kërkueses gjenden të konsumuara elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohej, duke arsyetuar se ajo, me dashje direkte, ka paraqitur të dhëna të rreme në përmbajtjen e dy dokumenteve në fjalë, ndërkohë që për shkak të pozicionit të punës ka pasur dijeni që punonjësja R.Sh. nuk ka qenë e pranishme në punë për atë periudhë. Sipas gjykatës, kërkuesja ka përdorur rrethanat e rreme për të justifikuar rregullshmërinë e punës së saj dhe, njëkohësisht, me anë të paraqitjes së tyre në procesverbalin e datës 31.10.2013, ka fshehur faktin që llogaritarja R.Sh. nuk ka qenë e pranishme në punë për një periudhë 1-mujore, duke u paguar padrejtësisht. Sipas arsyetimit të gjykatës, veprimet e kërkueses i plotësojnë të gjitha elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve, duke përfshirë, si pasojë, përgjegjësi penale, civile dhe administrative, përgjegjësi këto që mundet të ekzistojnë edhe njëkohësisht. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë është paraqitur ankim nga kërkuesja, e cila ka kërkuar prishjen e tij dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të saj.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin 745, datë 21.12.2016, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të kërkueses, me arsyetimin se në veprimet e kërkueses nuk gjenden elemente të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, për të cilën ajo ishte deklaruar fajtores nga gjykata më e ulët. Në analizë të objektit të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i KP-së, gjykata e apelit ka arsyetuar se nuk rezulton që procesverbali i datës 31.10.2013 të përmbajë mospërputhje lidhur me gjendjen e arkës, çka provonte mungesën e qëllimit të falsifikimit të këtij dokumenti nga kërkuesja, e cila ka kryer nënshkrimin e procesverbalit në emër të llogaritares R.Sh. për të shmangur vonesat në punë në kushtet moszëvendësimit të saj, duke njoftuar për këtë edhe drejtuesin e shoqërisë në atë kohë. Sipas gjykatës së apelit, ky veprim i kërkueses nuk ka cenuar veprimtarinë e rregullt të personit juridik, për sa kohë përmbajtja e këtij dokumenti është i vërtetë. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, në veprimet e kërkueses mungonte edhe ana subjektive e veprës penale, pra “dashja”, ndërsa ajo kishte marrë miratimin e ish-drejtuesit të shoqërisë, duke vepruar kështu me pakujdesi, neglizhencë, nisur nga rëndësia e pakët e dokumentit në praktikën e përditshme të zyrës dhe pasur parasysh qëllimin e saj për vijimin e punës. Lidhur me pasqyrimin e punonjës R.Sh. në listëpagesat e shoqërisë për muajt tetor dhe nëntor 2013, gjykata e apelit ka pranuar se një gjë e tillë nga kërkuesja është bërë me dijeninë e drejtuesit të mëparshëm të shoqërisë, me bindjen se mosparaqitja në punë në atë rast ka qenë një marrëveshje punëmarrës-punëdhënës. Sipas gjykatës së apelit, përfitimi i një page mujore nga punonjësja në fjalë pa u paraqitur në punë është mosmarrëveshje civile, që, si e tillë, duhet të trajtohet sipas Kodit të Punës. Kundër këtij vendimi ka ushtuar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke kërkuar prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndaj rekursit të prokurorit, kërkuesja ka paraqitur kundërrekurs, duke kërkuar mospranimin e rekursit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1715 datë 20.12.2022, ka prishur e vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndërsa e ka vlerësuar të drejtë rekursin e prokurorit për zbatimin e gabuar të ligjit material penal nga gjykata e apelit në lidhje me identifikimin e elementeve të veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186, paragrafi 2, i KP-së. Sipas Kolegjit Penal, në rastin konkret, kontrolli rishikues shtrihej në drejtim të verifikimit të zbatimit të ligjit penal nga gjykata e apelit, për sa kohë ajo vendimmarrje e saj për mungesën e veprës penale e ka mbështetur në elementet konstitutive të saj, duke prezantuar në mënyrë të papërshtatshme si të tillë qëllimin e fitimit, si dhe duke e degraduar formën e fajit në neglizhencë dhe pakujdesi. Në

analizë të përmbajtjes së nenit 186 të KP-së, Kolegji Penal ka arsyetuar se nga ana objektive, vepra penale e “Falsifikimit të dokumenteve” kryhet në dy forma: nëpërmjet “*falsifikimit të dokumenteve*” (ndërhyrjes në një dokument, duke paraqitur rrethana të rreme në një pjesë apo në tërësinë e tij); dhe nëpërmjet “*përdorimit të dokumenteve të falsifikuara*” nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se kjo veprë penale, ashtu si të gjitha figurat e tjera të veprave penale të parashikuara në KP, në seksionin “Falsifikimi i dokumenteve”, nga ana subjektive, kryhet vetëm me dashje direkte, pa u kushtëzuar nga elemente të tjera, siç mund të jenë interesi, qëllimi, përfitimi personal etj. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e shkallës së parë, në ndryshim nga gjykata e apelit, ka argumentuar në mënyrë ezauruese prezencën e elementeve integrale të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 186, paragrafi 2, i KP-së, në kushtet e verifikimit të rrethanave të rreme të pasqyruara në përmbajtjen e dy dokumenteve në lidhje me punonjësen R.Sh., dokumente këto të përpiluara dhe të firmosura nga vetë kërkuesja, si dhe për sa kohë që “qëllimi” (motivi) i kryerjes së kësaj vepre penale konsiderohet i parëndësishëm në drejtim të cilësimit juridik të saj. Kolegji Penal ka pranuar se vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është në respektim të ligjit material dhe procedural, në drejtim të plotësisë së arsyetimit të vendimit të lidhur me vlerësimin e provave, në funksion të tejkalimit të “pragut” të standardit provues të përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 4 të KPP-së, atij të verifikimit të fajësisë së kërkueses në nivelin provues “tejtë dyshimit të arsyeshëm”.

5. Në datën 18.04.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, sipas objektit të saj.

II

Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar:

6.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1.1 *Së drejtës për një gjykim të drejtë*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka deklaruar kërkuesen fajtoreshë për një fakt që nuk përbën veprë penale, sikurse ka pranuar Gjykata e Apelit Vlorë, ndërsa vendimi i saj është marrë në shkelje të neneve 3 dhe 152 të KPP-së, në rrethanat kur nuk ka vlerësuar provat në tërësi

dhe në përputhje me njëra-tjetrën, si dhe duke mos çmuar vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre. Po kështu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për një rekurs të prokurorit që nuk përmbante shkaqe, si dhe duke interpretuar ligjin material penal në tejkalim të përcaktimeve që parashikojnë nenet 13 dhe 186, paragrafi 2, të KP-së, të cilët kërkojnë ekzistencën e pasojës së veprës penale, çka në rastin konkret nuk ka ardhur dhe nuk mund të vinte, duke treguar në këtë mënyrë edhe kjo gjykatë qëndrim të njëanshëm në favor të organit të akuzës.

6.1.2 *Parimit të barazisë së armëve*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë iu ka dhënë vlerë të paracaktuar provave dhe pretendimeve të organit të akuzës, duke anashkaluar pretendimet e kërkuases për rrethanat e faktit penal, për të cilin akuzohej.

6.1.3 *Së drejtës për t'u dëgjuar*, të garantuar nga neni 31 i Kushtetutës, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi, pa e njoftuar dhe pa dijeninë e saj, në mosrespektim të nenit 436 të KPP-së, duke mos i dhënë mundësinë për t'u dëgjuar në lidhje me kundërrekursin e ushtruar.

6.2. *E drejta për punë dhe e imazhit*, pasi deklarimi fajtores në mënyrë të padrejtë ka passjellë për kërkuosen prishjen e imazhit në komunitetin ku jeton duke e bërë të pamundur punësimin në institucione shtetërore dhe subjekte private në profesionin, për të cilin është diplomuar dhe që e ka ushtruar pa asnjë vërejtje në shumë vite pune.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuases

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit

71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kritereve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Në verifikim të plotësimit të këtyre kritereve, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në gjykimin për të cilën janë dhënë vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi në Gjykatë.

9. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, konstatohet se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm, ku vendimi i fundit që ajo kundërshton është ai i Gjykatës së Lartë, ndaj, për rrjedhojë, kërkuesja i ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

10. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit që ka përmbyllur procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj saj, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është i datës 20.12.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 18.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 23, datë 20.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se, në mbështetje të pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të një gjykimi të drejtë, kërkuesja ka parashtruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka deklaruar fajtores për një fakt që nuk përbën vepër penale, sikurse ka pranuar Gjykata e Apelit Vlorë, ndërsa vendimi i saj është marrë në shkelje të neneve 3 dhe 152 të KPP-së, në rrethanat kur nuk ka

vlerësuar provat në tërësi dhe në përputhje me njëra-tjetrën, si dhe duke mos çmuar vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre. Po kështu, sipas kërkueses, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për një rekurs të prokurorit që nuk përmbante shkaqe, si dhe duke interpretuar ligjin material penal në tejkalim të përcaktimeve që parashikojnë nenet 13 dhe 186, paragrafi 2, të KP-së, të cilët kërkojnë ekzistencën e pasojës së veprës penale, çka në rastin konkret nuk ka ardhur dhe nuk mund të vinte, duke treguar në këtë mënyrë edhe kjo gjykatë qëndrim të njëanshëm në favor të organit të akuzës.

13. Në lidhje nga sa më lart, Kolegji vlerëson se këto pretendime të kërkueses janë me natyrë ligjore dhe kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, interpretimin dhe zbatimin e ligjit, çështje të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues. Gjykata ka pohuar se mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, por jo për mënyrën e vlerësimit (*shih vendimet nr. 23, datë 17.05.2010; nr. 45, datë 10.10.2010; nr. 37, datë 19.09.2011*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, duke qenë se kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se si vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për një gjykim të drejtë, Kolegji çmon se ajo nuk ka arritur ta ngrejë këtë pretendim në nivel kushtetues, për rrjedhojë ky pretendim nuk mund të shqyrtohet.

14. Kërkuësja pretendon, gjithashtu, se i është cenuar e drejta për punë dhe e imazhit, duke parashtruar se deklarimi fajtores në mënyrë të padrejtë passjellë prishjen e imazhit në komunitetin ku jeton, duke e bërë të pamundur punësimin në institucione shtetërore dhe subjekte private në profesionin për të cilin është diplomuar dhe që e ka ushtruar pa asnjë vërejtje në shumë vite pune. Ky pretendim i kërkueses ngrihet mbi premisën se vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë janë të padrejta, pretendim ky i fundit që, siç u parashtrua më lart, nuk është ngritur në nivel kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për punë dhe e imazhit nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe për këtë arsye nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuases, që kanë të bëjnë me cenimin e parimit të barazisë së armëve, së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar, *prima facie* janë me natyrë kushtetuese, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

16. Kërkuësja ka pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë iu ka dhënë vlerë të paracaktuar provave dhe pretendimeve të organit të akuzës, duke anashkaluar pretendimet e saj për rrethanat e faktit penal për të cilin akuzohej.

17. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëjës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklaramit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në jurisprudencë të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se është gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr.9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së armëve nuk i imponon gjykatës që të pranojë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr.19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në këndvështrim të këtyre standardeve, Kolegji vëren se në procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk rezulton që kërkuësja të jetë vënë në pozita të pabarabarta me palën tjetër në gjykim. Ajo ka qenë e pranishme gjatë gjykimit, i cili për kërkesën e saj është zhvilluar me ritin e posaçëm, gjykimit të shkurtuar, çka, sipas ligjit, konsideron

administrimin të gjitha akteve procedurale dhe provave të marra gjatë hetimeve paraprake, ku në këtë aspekt kërkuesja nuk paraqet ndonjë pretendim konkret. Gjatë atij gjykimi, sikundër nuk kontestohet, kërkueses i është dhënë mundësia të dëgjohet për provat e çështjes në kushte të barabarta me organin e akuzës, të debatojë në lidhje me to, si dhe të paraqesë argumente në mbështetje të pretendimeve të saj. Së fundi, në marrjen e vendimit, ajo gjykatë ka vënë në balancë faktet e provuara në gjykim me rëndësi për zbatimin e ligjit penal dhe nuk rezulton që kërkuesja të jetë vënë në situatë jo të favorshme ose që pretendimet e saj të mos jenë vlerësuar, në krahasim me ato të organit të akuzës. Vetëm fakti që gjykata nuk i ka pranuar pretendimet e saj, nuk vë në dyshim respektimin e parimit të barazisë së armëve, për sa kohë ajo ka arsyetuar në vendim shkaqet mbi të cilat ka mbështetur qëndrimin e saj.

20. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të barazisë së armëve, është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar

21. Kërkuesja pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi, pa e njoftuar dhe pa dijeninë e saj, në mosrespektim të nenit 436 të KPP-së, duke mos i dhënë mundësinë për t'u dëgjuar në lidhje me kundërrekursin e ushtruar.

22. Jurisprudenca e Gjykatës ka pranuar si elemente përbërëse të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën për t'u dëgjuar. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, para marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, Gjykata është shprehur se kjo e fundit ka detyrimin që jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t'u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Gjykata e Lartë duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimin nr.17, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në referim të ndryshimeve të reja të KPP-së në lidhje me shqyrtimin e çështjeve në dhomë këshillimi, në nenin 436 të tij përcaktohen rregullat e shqyrtimit të çështjeve sipas kësaj forme gjykimi, dhe po ashtu edhe mënyra e njoftimit të palëve. Sipas kësaj dispozite, për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykit të paktën 30 ditë përpara, ndërkohë që kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara ose të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa. Shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi, pra mbi bazë dokumentesh, është forma e gjykit që ndiqet, si rregull, në Gjykatën e Lartë, përcaktuar kjo nga neni 436/a, pika 1, i KPP-së.

25. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji konstaton se pas rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kërkuesja ka paraqitur kundërrekurs, fakt ky që tregon se ajo ka marrë dijeni për rekursin e prokurorit dhe, për rrjedhojë, nëpërmjet kundërrekursit, ka ushtruar të drejtën për t'u mbrojtur për çka është ngritur në të. Në vijim, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në datën 11.11.2022, janë publikuar çështjet që do të gjykoreshin nga Kolegji Penal në dhomë këshillimi në datën 20.12.2022, ku ndër to ka qenë edhe çështja e kërkueses. Ndërkohë, nuk pretendohet për mosafishimin e këtij njoftimi në këndin e njoftimeve të Gjykatës së Lartë apo që kërkuesja ose mbrojtësi i saj të kenë lënë adresa elektronike për qëllime njoftimi. Për pasojë, nuk duket që Gjykata e Lartë të ketë vepruar në shkelje të dispozitave procedurale të zbatueshme për njoftimin e palëve dhe publikimin e datave të shqyrtimit të çështjeve në atë gjykatë, duke garantuar njëkohësisht edhe të drejtën e kërkueses për të paraqitur parashtrime në kuadër të realizimit të së drejtës së mbrojtjes.

26. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar, është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.